

VENDIM
Nr.1387, datë 17.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.532, DATË 21.8.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LEJET E TRANSPORTIT TË MALLRAVE PËR TRANSPORTUESIT,
QË NUK KANË SELI NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.532, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kontrolli i lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave për çdo kamion bëhet nga organet doganore të policisë kufitare dhe nga organet e kontrollit shtetëror të specializuar, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fillim të çdo viti ose rast pas rasti, njofton organet e mësipërme për llojet dhe sasinë e lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave, që shkëmbehen me çdo shtet, si dhe shtetet, kamionët e të cilave përjashtohen nga lejet e transportit ndërkombëtar të mallrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha